

# KAMPIONJA BOTËRORE ÇMON LART BOKSIN SHQIPTAR

*Christina Nigg është e vetmja boksierë profesioniste në Zvicër dhe njëherit kampione botërore në boks për vitin 1998*

Më 26 dhjetor të vitit të kaluar në Bernë u shënua "Dita e boksit zviceran". Në shenjë të këtij manifestimi sportiv në një pallat sportiv të kryeqendrës së Zvicrës u mbajt një turnir boks, ku morën pjesë edhe tre boksierë shqiptarë me qëndrim në Zvicër dhe që të tre ngadhënjyen me lojëra të forta e tërheqëse.

Për të përcjellur këtë garë të rëndësishme, pos shumë adhuruesëve të këtij sporti kishte ardhur për të marrë pjesë edhe kampionja botërore në boks për vitin 1998 dhe e vetmja boksierë profesioniste në Zvicër, z. Christina Nigg. Gjatë pauzës, derisa ishte në shoqërim të disa boksierëve shqiptarë, zhvilluam një bisedë të shkurtër me këtë kampione, nga e cila mësuamë se ajo jeton në Thun, porse fillet e boksit i ka prej klubit amator "Box-Club Singen" të Gjermanisë.

Gjatë karrierës disavjeçare Christina Nigg ka arritur të fitojë disa kupa e medalje, ndërsa që në garat ndërkombëtare ka arritur 11 fitore 6 humbje dhe një barazim. Lidhur me përmasat e boksit në Zvicër, ajo thotë se ky sport është i ri në këtë shtet, porse nga viti në vit ka filluar të përhapet në shumicën e kantoneve, madje edhe duke përfjetuar një ngritje gjithnjë e më cilësore dhe duke shtuar edhe vazhdimisht edhe publikun. Meritën për afirmimin e këtij



*Christina Nigg, kampionja botërore në boks*



sporti në Zvicër, Christina Nigg ia përshkruan ardhjes së të huajve, në mesin e të cilëve bëjnë pjesë edhe boksierët shqiptarë.

-Kam një admirim të veçantë për boksën dhe boksierët shqiptarë. Viteve të fundit këtu në Zvicër, po edhe në Gjermani kam pa disa boksierë shqiptarë sesi luftojnë në ring, duke demonstruar boks cilësor e luftarak. Edhe në garën e sotme patëm rastin të shohim boksierët e ri shqiptarë me qëndrim në Zvicër se sa janë të guximshëm e atraktiv në ring, -përfundon kampionja botërore në boks.

R. Rifati

← *Zviceranja numër një në boksën profesionist (IBC) në shoqërim të vëllezërve Nuri e Sefer Seferi, që të dy kampion zviceranë në boksën amatorë*